

Monitorimi / Vlerësimi tematik



**Afatet e shqyrtimit gjyqësor
të Kolegjit Administrativ
të Gjykatës së Lartë
2015 - 2016**

Implementuar nga:



**Tiranë,
Gusht 2017**

Mbështetur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world



Promoting Transparency and Accountability of the Judiciary

Monitorimi / Vlerësimi tematik

**Afatet e shqyrtimit gjygjësor
të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë
2015 - 2016**

**Tiranë,
Gusht 2017**

Drejtësi e vonuar, drejtësi e munguar !

Raporti Special për Gjykatën e Lartë të RSH

Vlerësimi tematik për afatet procedurale të shqyrtimit gjyqësor dhe dorëzimit të dosjeve nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, 2015 - 2016

I. Hyrje

Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP ka vlerësuar afatet procedurale të shqyrtimit gjyqësor dhe të dorëzimit të vendimeve nga Kolegji Administrativ të Gjykatës së Lartë. Ky vlerësim tematik realizohet për herë të parë që nga momenti i krijimit të këtij Kolegji¹ dhe përbën një gur themeli si në drejtëm të gjetjeve ashtu dhe të metodologjisë së përdorur.

Monitorimi i realizuar nga INFOCIP është mbështetur nga National Endowment for Democracy, me seli në Washington D.C, (SHBA) që financohet kryesisht me fonde të Kongresit Amerikan.

Në terma kohore, monitorimi mbulon vitin 2015 dhe 2016. Ai analizon dhe evidenton situatën e vonesave në shqyrtimin gjyqësor dhe dorëzimin e dosjeve në Kolegjin Administrativ të GJL. Të dhënat e monitorimit shërbejnë për të përlllogaritur gjithashtu nivelin e zbatimit të ligjit Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, (ndryshuar me ligjin nr. 100/2014).

¹ Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ndryshuar me ligjin nr. 100/2014.

Në respekt të staturës së rëndësishme institucionale të GJL, si maja e piramidës së gjyqësorit në RSH, të gjitha vendimet e dhëna nga Kolegji Administrativ gjatë viti 2015 dhe 2016 janë disponuar të plota dhe janë analizuar një për një nga INFOÇIP. Konkretisht, për vitin 2016 dhe 2015 janë disponuar respektivisht 604 dhe 710 vendime të dhëna nga Kolegji Administrativ i GJL. Kjo qasje *holistike* (pa kapionim) krijon mundësi për një skaner real të situatës, me një marzh gabimi minimale (më pak se 1%).

Të dhënat mbi afatet procedurale që analizon studimi janë disponuar nga regjistrat e numërtimit që administrohen nga sekretaria e Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, Z. Xhezair Zaganjori pranoi në fillim të vitit 2017 kërkesën zyrtare të INFOÇIP për të disponuar këto të dhëna dhe garantoj akses të plotë në realizimin e këtij procesi. Të dhënat janë administruar në format letër fillimisht dhe më pas janë hedhur dhe përpunuar në sistemet kompiuterike të dizenuara enkas për këto lloj vlerësimi nga INFOÇIP.

Në total, për të dyja vitet e marra, INFOÇIP disponoi nga Gjykata e Lartë 21024 njësi të dhënash të matshme, prej të cilave analizës së posaçme për efekte të këtij vlerësimi tematik iu nënshtruan 14454 njësi, të cilat përfaqësojnë, ndër të tjerat, numrin e aktit, numrin e vendimit, datën e regjistrimit, datën e seancës, datën e dorëzimit, datën e perfundimit etj... Nga përpunimi i të dhënave u gjeneruan 6570 njësi me të dhëna unike, të cilat nuk përmbahen në regjistrat e gjykatave dhe që janë produkt i drejtpërdrejtë i analizës së zhvilluar nga INFOÇIP.

Ky volum kaq i madh të dhënash përfaqëson një rekord historik në vlerësimet tematike të tipit “*evidence-based*” të ndërmara ndonjëherë ndaj Gjykatës së Lartë të RSH. Për më tepër, ky është i vetmi vlerësim i këtij lloji edhe për faktin se, që nga krijimi i saj e deri në aktivizimin e Reformës në Drejtësi, edhe vetë inspektoratet e KLD dhe të Ministisë së Drejtësisë nuk kanë patur asnjë kompetencë vlerësimi tematik (apo incidental) ndaj kësaj Gjykate, për shkak të konfigurimit të posaçëm institucional si maja e piramidës gjyqësore në RSH. Rrjedhimisht, të dhënat e gjeneruara nga INFOÇIP kanë një interes të posaçëm, jo thjesht për metodologjinë e përdorur, por së pari për zbardhjen për herë të parë të situatës së zbatimit të afateve ligjore nga kjo gjykatë.

Monitorimi Special i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është pjesë e Programit të Monitorimit Kombëtar të sistemit të Gjykatave Administrative të RSH. Në javët në vijim, INFOCIP do të publikojë gjetjet për të gjitha gjykatat administrative në vend. Arsyeja e anulimit të gjetjeve të monitorimit për Gjykatën e Lartë në një event të posaçëm ka të bëjë së pari me të dhënat shqetësuese të identifikuara sa i takon vonesave në shqyrtim, por edhe me situatën e rëndë të stafëve dhe numrit në rënie të trupës gjyqësore dhe stafëve ndihmëse në këtë Gjykatë. Nëse nuk merren masa urgjente për të rikuperuar situatën, viti 2017 mund të sjellë një përkeqësim të mëtejshëm të treguesve të performancës dhe shtim të vonesave procedurale në gjykim.

II. Gjetjet e Vlerësimit Tematik për vitin 2016

❖ Afati i shqyrtimit gjyqësor, 2016

Gjykata e Lartë shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi (neni 60², pika 2 e ligjit nr. 49/2012, *të ndryshuar*). Gjykata administrative e shkallës së parë dërgon rekursin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqarit për pranimin e rekursit, aktet e komunikimit të rekursit, kundër-rekursin, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën e Lartë, brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve³.

Për të vlerësuar kohëzgjatjen e procesit gjyqësor administrative në GJL, i cili në ligj parashikohet të jetë 90 ditë, nevojitet disponimi i datës së regjistrimit të rekursit dhe data e vendimit të çështjes. Rregjistrat e Gjykatës së Lartë nuk dokumentojnë datën e ardhjes së rekursit me attribute të plota kalendarike (shënohet vetëm viti, por jo dita dhe muaji). Në kuadër të këtij Raporti, kjo konsiderohet një “e metë” në sistemin e mbajtjes së të dhenave nga GJL.

Për efekt të këtij monitorimi, data e saktë e ardhjes së rekursit është gjeneruar nga operatorët e INFOCIP përmes metodës së kryqëzimit të të dhënave me

² Neni 60 “Dërgimi i rekursit në Gjykatën e Lartë”

³ Neni 60, pika 1.

burime të tjera parësore që administrohen nga vetë GJL. Nga ana tjetër, data e vendimit është një e dhënë e cila dokumentohet rigorozisht në fletët e regjistrave të GJL.

Vendimet dhe të dhënat lidhur më objektin e këtij vlerësimi tematik u disponuan përmes komunikimit shkresor më Kryetarin e Gjykatës së Lartë, Z. Xhezair Zaganjori, në fillim të vitit 2017. Gjetjet dhe konkluzionet që parashtrihen më poshtë i janë vënë në dispozicion paraprakisht Gjykatës së Lartë për të konfirmuar konsistencën e vlerësimit. Deri në Korrik 2017, kohë në të cilën përfundoi ky Raport, nuk ka patur asnjë reklamim nga ana e Gjykatës së Lartë për inkonsistencë në vlerësimin e të dhënave dhe për rezultatet e gjeneruara nga përpunimi i tyre.


Gjatë vitit 2016, Kolegji Administrativ i GJL dha gjithsej 604 vendime gjyqësore. Prej tyre në analizë për efekt të këtij vlerësimi u morën 575 vendime⁴. Nga analiza rezultoi se vetëm 2 nga 575 çështjet e vendimuara në 2016-ën janë shqyrtuar **brenda afatit ligjor 90-ditor**, sikurse parashikon ligji 49/2012, *i ndryshuar* (tab 1, graf 1). Dy çështjet e shqyrtuara brenda afatit në vitin 2016 përfaqësojnë vetëm 0.3% të totalit. Kjo e dhënë përfaqëson njëkohësisht edhe nivelin e zbatimit të neni 60⁵, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, *të ndryshuar* nga Kolegji Administrativ i GJL për vitin 2016. Në kuadër të metodologjisë së këtij vlerësimi, zbatueshmëria nën 1% e dispozitës ligjore në fuqi konsiderohet *nivel shumë i ulët i zbatimit të ligjit*.

⁴ Për 29 vendime, të dhënate disponuara në letër nga regjistri janë të palexueshme në tërësi të datës së rregjistrimit dhe janë përjashtuar nga vlerësimi për efekt metodologjik të shmangies së gabimit njëzëror në hedhjen e të dhënave.

⁵ Neni 60 “Dërgimi i rekursit në Gjykatën e Lartë”

Tabela 1, Grafiku 1

Nr.	Koha	Nr. vendimesh
1	0 - 90 dite	2
2	mbi 90 dite	573
	Totali	575



Kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit të një çështje në Kolegjin Administrativ të GJL gjatë vitit 2016 rezulton të jetë minimalisht 820 ditë. Kjo shifër e tejkalon mbi 9 herë afatin që parashikon ligji 49/2012, *i ndryshuar* për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative në GJL (90 ditë nga momenti i regjistrimit të rekursit).


Koha më e gjatë e shqyrtimit gjyqësor për çështjet e vendimuara në vitin 2016 nga Kolegji Administrativ i GJL është 2080 ditë⁶ ose 5.7 vjet nga data e regjistrimit të rekursit. Kjo është çështja gjyqësore me palë paditëse Shoqëria "Saudit Brothers Commercial Company" dhe palë të paditur Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës. Rekursi për këtë çështje është regjistruar në 04.04.2011 dhe, nga regjistri rezulton të jetë vendimuar në datë 13/12/2016 (*Nr. Vendimi: 00-2016- 3093 Dt. Vendimi: 13.12.2016*).

Shumica e çështjeve të vendimuara në vitin 2016 nga Kolegji Administrativ i GJL janë të grupuara në fashat kohore midis 500 dhe 1200 ditëve (tab. 2). Në këto fasha kohore janë të grupuara mbi 74% e gjithë totalit të çështjeve të shqyrtuara. Grafiku i më poshtëm ofron një vizualizim të shpërndarjes së kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor sipas fashave kohore 100-ditore gjatë vitit 2016.

⁶ Vendimi nr 2665 është marrë në datë 12.06.2016, ndërkohë që rekursi është regjistruar në gjykata në vitin 2010. Data e saktë e regjistrimit nuk identifikohet dot me metodën e kryqëzimit të të dhënave; rrjedhimisht përllogaritja në këtë rast bëhet me njësi vjetore, ku një vit llogaritet 365 ditë kalendarike.

Tabela 2

Periudha Janar - Dhjetor 2016			
Nr.	Fasha Kohore ne Dite	Nr vendimesh gjithsej	Shprehur ne %
1	0-100	2	0.35%
2	101-200	4	0.70%
3	201-300	18	3.13%
4	301-400	40	6.96%
5	401-500	26	4.52%
6	501-600	55	9.57%
7	601-700	44	7.65%
8	701-800	77	13.39%
9	801-900	86	14.96%
10	901-1000	67	11.65%
11	1001-1100	55	9.57%
12	1101-1200	42	7.30%
13	1201-1300	21	3.65%
14	1301-1400	18	3.13%
15	1401-1500	7	1.22%
16	1501-1600	5	0.87%
17	1601-1700	7	1.22%
18	1701-1800	0	0.00%
19	1801-1900	0	0.00%
20	1901- 2000	0	0.00%
21	2001 - 2100	1	0.17%
	Totali	575	100%

Grafiku 2


Ndërkohë, në tabelën 3 jepet një renditje e 50 çështjeve të vendimuara në vitin 2016 që reflektojnë edhe vonesat më të mëdha nga të gjitha vendimet e analizuara nga INFOÇIP në kuadër të këtij vlerësimi.

Tabela 3

Nr	Nr vendimi	Data e regjistrimit	Data e seances	Dite gjithesej
1	2739	29.04.2013	13.09.2016	1233
2	1002	06.11.2012	29.03.2016	1239
3	2799	12.12.2012	17.05.2016	1252
4		08.04.2013	13.09.2016	1254
5	1481	24.10.2012	19.04.2016	1273
6		26.06.2013	20.12.2016	1273
7	191	26.07.2012	26.01.2016	1279
8	17	07.09.2012	14.01.2016	1286
9	2826	18.04.2013	26.10.2016	1287
10	2699	09.04.2013	18.10.2016	1288
11	2449	07.03.2013	20.09.2016	1293
12	471	19.07.2012	09.02.2016	1300
13	490	01.08.2012	24.02.2016	1302
14	2899	16.04.2013	15.11.2016	1309
15	638	21.06.2012	28.01.2016	1316
16		05.04.2013	15.11.2016	1320
17	190	31.05.2012	26.01.2016	1335
18	3344	28.03.2013	24.11.2016	1337
19	1485	03.07.2012	02.03.2016	1338
20	674	13.07.2012	15.03.2016	1341
21		28.02.2013	01.11.2016	1342
22	2180	07.11.2012	12.07.2016	1343
23		08.04.2013	20.12.2016	1352
24	1007	10.07.2012	29.03.2016	1358
25	676	18.06.2012	15.03.2016	1366
26	2179	04.10.2012	12.07.2016	1377
27	675	05.06.2012	15.03.2016	1379
28		11.03.2013	20.12.2016	1380
29		06.03.2013	20.12.2016	1385
30	474	04.05.2012	23.02.2016	1390
31	2178	30.08.2012	12.07.2016	1412
32	1070	15.05.2012	05.04.2016	1421
33		29.01.2013	20.12.2016	1421
34	1974	23.05.2012	19.04.2016	1427
35	491	06.03.2012	24.02.2016	1450

36	536	05.03.2012	01.03.2016	1457
37	2742	05.09.2012	13.09.2016	1469
38	2741	03.08.2012	13.09.2016	1502
39	1483	07.03.2012	19.04.2016	1504
40	2744	06.03.2012	11.05.2016	1527
41	2447	02.07.2012	20.09.2016	1541
42	3226	11.07.2012	04.10.2016	1546
43	2072	01.09.2011	09.02.2016	1622
44	541	22.09.2011	01.03.2016	1622
45	2051	16.09.2011	01.03.2016	1628
46	3095	25.05.2012	13.12.2016	1663
47	2625	21.10.2011	17.05.2016	1669
48		11.05.2012	13.12.2016	1677
49		23.04.2012	14.12.2016	1696
50		04.04.2011	13.12.2016	2080

Nga analiza e të dhënave, rezulton se, përtej afatit ligjor të lejuar (90 ditë), Kolegji Administrativ i GJL konsumoi më e pakta 419724 ditë për çështjet që vendimoi në vitin 2016⁷. Këto janë afërsisht 1150 vjet. Me fjalë të tjera, palët të cilat morën një vendim në dorë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjatë vitit 2016 për çështje administrative, iu desh më parë të prisnin të gjithë se bashku (për 599 çështje rekursi) mbi 11 shekuj e gjysëm që drejtësia të shërbejë për ta nga gjykata më e rëndësishme në RSH.

❖ Afati i dorëzimit të vendimeve, viti 2016

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, parcakton qartësisht formën e shpalljes së vendimit dhe afatet e dorëzimit të dosjes në sekretarinë gjyqësore. Vendimi gjyqësor, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar. Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 10 ditë. Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.


⁷ 29 çështje nuk janë përfshirë në vlerësim

Objekt vlerësimi në këtë monitorim është pikërisht afati 10-ditor i dorëzimit të dosjes në sekretarinë gjyqësore. Për Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë ky vlerësim realizohet për herë të parë dhe synon të vendosë një gur themeli në monitorimet tematike për këtë gjykatë. Legjitimiteti parësor për këtë lloj vlerësimi buron nga ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Nga vlerësimi për vitin 2016, rezulton se, brenda afatit ligjor prej 10 ditësh janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës së Lartë vetëm 82 nga 595 vendime të analizuar **14%** e totalit⁸. Pjesa tjetër prej 513 vendimesh ose **86%** e totalit dalin jashtë këtij afati. Kjo do të thotë se për vitin 2016, dispozitat e nenit Neni 64, pika 3⁹ e ligjit 49/2012, të ndryshuar kanë gjetur zbatim në masën **14%** në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Tabela 4 Grafiku 3

Nr	Fasha kohore	Numri i vendimeve
1	0 - 10 dite	82
2	mbi 10 dite	513
	Totali	595



Ndërkohë, nga vlerësimi rezulton se 61.5% e totalit të vendimeve të analizuar janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës brenda 30 ditëve nga seanca përfundimtare. Ligji organik i Gjykatës së Lartë (në fuqi në kohën që analizon

⁸ Janë 9 vendime nga 6014 vendime në total të cilat nuk janë arrë në analizë për shkak të vështirësisë në leximin e të dhënave.

⁹ Neni 64, **Shpallja dhe depozitimi i vendimit, pika 3** : Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

ky vlerësim tematik) referon pikërisht këtë afat për dorëzimin e vendimeve të arsyetuara në sekretarinë e Gjykatës. Është e qartë në këtë pikë se dy ligje të ndryshme, për më tepër me të njëjtën hierarki normative, caktojnë afate të ndryshme përsa i takon të njëtin veprim procedural.

Nuk ekziston deri më sot gjithsesi një praktikë unifikuese për këtë problem procedural që prek pikërisht vetë funksionimin e kolegjeve të Gjykatës së Lartë të RSH. Për “brishtësi” metodoogjike në këtë rast, INFOCIP nuk aplikon në këtë rast vlerësim verbal për nivelin e zbatimit të ligjit. Ajo që mund të thuhet gjithsesi është se situata e vonesave në dorëzimin e vendimeve përfundimtare (dosjeve) në sekretarinë e gjykatës paraqitet relativisht shumë më mirë se sa situata e kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor për vitin 2016.

Kohëzgjatja mesatare e dorëzimit në sekretarinë e Gjykatës së Lartë të një dosje gjyqësore të vendimuar gjatë 2016-ës rezulton të jetë 32.3 ditë. Kjo shifër e tejkalon 3 herë afatin që parashikon ligji 49/2012, *i ndryshuar* për dorëzimin e dosjes për çështjeve administrative në shkallën e tretë të gjykimit dhe pothuajse është në ekuilibër me afatin 30-ditor që përcaktonte neni 19¹⁰ i ligjit Nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të RSH”, *i ndryshuar*¹¹.

Koha më e gjatë e dorëzimit të një dosje në sekretarinë e GJL për çështjet e vendimuar në vitin 2016 nga Kolegji Administrativ i GJL është 332 ditë. Kjo është çështja gjyqësore me paditës Paskal Jorgji dhe të paditur Zyra Arsimore Ersekë, e cila është vendimuar në datë 08.03.2016 dhe dosja rezultojn të jetë dorëzuar në datë 14.04.2016.

Në tabelën më poshte jepet një renditje e 50 çështjeve të vendimuara në vitin 2016 që reflektojnë edhe vonesat më të mëdha në dorëzimin e dosjes gjyqësore nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

¹⁰ Neni 19 **Vendimet dhe botimi i tyre**: “Vendimet e Gjykatës së Lartë shpallen të arsyetuara jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor. Vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimet e pakicës, botohen në Buletinin Periodik të Gjykatës së Lartë. Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare”.

¹¹ *ndryshuar me ligjin nr. 151/2013, ndryshuar me ligjin nr. 177/2014.*

Tabela 5

50 rastet e dorezimeve me ekstreme te vendimeve ne vitin 2016				
Nr.	Nr vendimi	Data e seances	Data e dorezimit	vonesa
1	675	15.03.2016	18.05.2016	64
2	2625	17.05.2016	20.07.2016	64
3	2743	24.05.2016	27.07.2016	64
4	469	09.02.2016	15.04.2016	66
5	2072	09.02.2016	15.04.2016	66
6	2736	11.10.2016	16.12.2016	66
7	1331	25.02.2016	03.05.2016	68
8	535	25.02.2016	03.05.2016	68
9	3334	05.10.2016	13.12.2016	69
10	2184	04.05.2016	13.07.2016	70
11	2799	17.05.2016	26.07.2016	70
12	2121	28.04.2016	08.07.2016	71
13	1631	10.03.2016	23.05.2016	74
14	2546	15.06.2016	28.08.2016	74
15	187	26.01.2016	11.04.2016	75
16	488	24.02.2016	09.05.2016	75
17	1916	25.02.2016	13.05.2016	78
18	1422	26.04.2016	13.07.2016	78
19	2744	11.05.2016	28.07.2016	78
20	468	09.02.2016	28.04.2016	79
21	1885	28.01.2016	19.04.2016	82
22	1467	11.02.2016	03.05.2016	82
23	1462	11.02.2016	03.05.2016	82
24	1458	11.02.2016	03.05.2016	82
25	1421	26.04.2016	21.07.2016	86
26		15.11.2016	10.02.2017	87
27	2685	30.06.2016	26.09.2016	88
28	2701	30.06.2016	27.09.2016	89
29	1482	21.04.2016	20.07.2016	90
30		22.11.2016	20.02.2017	90
31	1483	19.04.2016	19.07.2016	91
32		15.11.2016	14.02.2017	91
33	1481	19.04.2016	20.07.2016	92
34		01.11.2016	07.02.2017	98
35		12.04.2016	26.07.2016	105
36	1000	29.03.2016	13.07.2016	106
37	3143	13.07.2016	03.11.2016	113
38	223	19.01.2016	26.05.2016	127

39	3144	06.07.2016	11.11.2016	128
40	2694	11.05.2016	19.09.2016	131
41	2684	11.05.2016	21.09.2016	133
42	2693	11.05.2016	21.09.2016	133
43	3072	13.07.2016	23.11.2016	133
44	3089	13.07.2016	24.11.2016	134
45	3189	28.06.2016	30.11.2016	155
46	2992	04.02.2016	19.07.2016	166
47	2686	31.03.2015	19.09.2016	172
48	1005	29.03.2016	21.10.2016	206
49	229	26.01.2016	07.09.2016	224
50	1489	08.03.2016	14.04.2016	332

Nga një përlllogaritje e posaçme, realizuar nga vlerësuesit e INFOÇIP, rezulton se në total, për dosjet e vendimuara në vitin 2016 nga KA i GJL, u akumulua një total vonesash për dorëzimin e tyre në sekretari prej 13225 ditësh, ose rreth 36 vjet në total. Duhet theksuar se kontrastimi në këtë rast është bërë me afatin ligjor që parashikohet në nenin 64, pika 3 e ligjit 49/2012, të ndryshuar dhe jo më atë që përmbante neni 19 i ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, i ndryshuar.

III. Gjetjet e Vlerësimit Tematik për vitin 2015

❖ Afati i shqyrtimit gjyqësor, 2015


Gjatë vitit 2015, Kolegji Administrativ i GJL dha 710 vendime gjyqësore. Në analizë nga INFOÇIP u morën 709 vendime (të dhënat e një vendimi ishin të palexueshme). Nga vlerësimi rezultoi se vetëm 4 nga 709 çështjet e vendimuara në 2015-ën janë shqyrtuar **brenda afatit ligjor 90-ditor**, sikurse parashikon ligji 49/2012, i ndryshuar.

Çështjet e shqyrtuara brenda afatit në vitin 2015 përfaqësojnë vetëm 0.5% të totalit. Kjo e dhënë përfaqëson njëkohësisht edhe nivelin e zbatimit të nenit

60¹², pika 2 e ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për çështjet e vendimuar në 2015-ën. Në kuadër të metodologjisë së këtij vlerësimi, zbatueshmëria nën 1% e dispozitës ligjore në fuqi konsiderohet *nivel shumë i ulët i zbatimit të ligjit*.

Tabela 6, Grafiku 4

Nr	Fasha kohore	Numri i vendimeve
1	0 - 90	4
2	mbi 90	705
	Totali	709



Kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit të një çështje në Kolegjin Administrativ të GJL gjatë 2015-ës rezulton të jetë 954 ditë. Kjo shifër e tejkalon mbi 10 herë afatin që parashikon ligji 49/2012, i ndryshuar për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative në shkallën e tretë të gjyqimit.

Koha më e gjatë e shqyrtimit gjyqësor për çështje të vendimuar në vitin 2015 nga Kolegji Administrativ i GJL është 1889 ditë ose 5.3 vjet nga data e regjistrimit të rekursit. Kjo është çështja me paditës: Shoqëria “BRUNO” SH.P.K dhe palë të paditur Dega e Doganës Durrës. Data e regjistrimit të rekursit është 03.09.2010 kurse data e vendimit 05.11.2015 (Nr.Akti: 31001-01852-00-2010).

Në tabelën 7 jepet një renditje e 50 çështjeve të vendimuar në vitin 2015 që reflektojnë edhe vonesat më të mëdha nga të gjitha vendimet e analizuar në kuadër të këtij monitorimi.

¹² Neni 60 “Dërgimi i rekursit në Gjykatën e Lartë”

Tabela 7


Nr.	DATE REGJISTRIMI	DATE SEANCE	Dite shqyrtimi gjithsej
1	08.09.2011	04.06.2015	1365
2	10.05.2011	05.02.2015	1367
3	20.12.2011	18.09.2015	1368
4	21.02.2012	24.11.2015	1371
5	22.02.2012	26.11.2015	1373
6	29.02.2012	03.12.2015	1373
7	26.05.2011	05.03.2015	1379
8	26.01.2012	05.11.2015	1379
9	19.05.2011	28.02.2015	1381
10	26.05.2011	12.03.2015	1386
11	17.02.2012	09.12.2015	1391
12	30.05.2011	26.03.2015	1396
13	04.05.2011	28.02.2015	1396
14	13.07.2011	12.05.2015	1399
15	19.07.2011	19.05.2015	1400
16	04.05.2011	05.03.2015	1401
17	28.03.2011	29.01.2015	1403
18	18.07.2011	26.05.2015	1408
19	21.04.2011	28.02.2015	1409
20	01.04.2011	10.02.2015	1412
21	27.04.2011	02.04.2015	1436
22	02.03.2011	10.02.2015	1441
23	08.02.2011	20.01.2015	1442
24	31.01.2011	15.01.2015	1445
25	29.09.2011	15.09.2015	1447
26	26.01.2011	13.01.2015	1448
27	25.01.2011	13.01.2015	1449
28	18.03.2011	10.03.2015	1453
29	11.05.2011	05.05.2015	1455
30	05.05.2011	12.05.2015	1468
31	27.04.2011	05.05.2015	1469
32	17.05.2011	02.06.2015	1477
33	14.01.2011	03.02.2015	1481
34	28.01.2011	17.02.2015	1481
35	15.04.2011	05.05.2015	1481
36	21.04.2011	12.05.2015	1482
37	28.03.2011	19.04.2015	1483
38	04.04.2011	05.05.2015	1492

39	02.05.2011	02.06.2015	1492
40	28.04.2011	09.06.2015	1503
41	11.02.2011	26.03.2015	1504
42	09.02.2011	19.04.2015	1530
43	26.01.2011	17.04.2015	1542
44	20.12.2010	17.03.2015	1548
45	02.05.2011	15.09.2015	1597
46	15.04.2011	13.10.2015	1642
47	28.04.2010	10.03.2015	1777
48	15.03.2010	10.03.2015	1821
49	11.11.2010	10.11.2015	1825
50	03.09.2010	05.11.2015	1889

Rezulton se shumica e çështjeve të vendimuara në vitin 2015 janë të grupuara në fashat kohore midis 600 dhe 1400 ditësh. Në këto fasha kohore janë të grupuara mbi 81% e gjithë totalit të çështjeve të shqyrtuara në 2015. Tabela dhe grafiku i më poshtëm ofron një vizualizim të shpërndarjes së kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor sipas fashave kohore 100-ditore gjatë vitit 2015.

Tabela 8

Periudha Janar - Dhjetor 2015			
Nr.	Fasha Kohore	Nr i vendimeve	Shprehur ne %
1	0-100	5	0.71%
2	101-200	13	1.83%
3	201-300	10	1.41%
4	301-400	9	1.27%
5	401-500	20	2.82%
6	501-600	40	5.64%
7	601-700	42	5.92%
8	701-800	65	9.17%
9	801-900	89	12.55%
10	901-1000	83	11.71%
11	1001-1100	85	11.99%
12	1101-1200	71	10.01%
13	1201-1300	88	12.41%
14	1301-1400	54	7.62%
15	1401-1500	24	3.39%
16	1501-1600	6	0.85%
17	1601-1700	1	0.14%
18	1701-1800	1	0.14%
19	1801-1900	3	0.42%
	Totali	709	100%

Grafiku 5


Përtej afatit ligjor të lejuar për shqyrtimin e rekurseve (90 ditë), Kolegji Administrativ i GJL konsumoi **më e pakta 616572** ditë për çështjet e vendimuara në vitin 2015. Këto janë afërsisht 1600 vjet ose 16 shekuj të konsumuar përtej afatit ligjor për shqyrtimin e një rekursi administrativ në Gjykatën e Lartë. Me fjalë të tjera, subjektet të cilat morën një vendim në dorë një vendim nga GJL gjatë vitit 2015 për çështje administrative, iu desh më parë të prisnin të gjithë se bashku mbi 16 shekuj e gjysëm që drejtësia të shërbehej për ta.

❖ Afati i dorëzimit të vendimeve, viti 2015


Nga vlerësimi rezulton se, brenda afatit ligjor prej 10 ditësh janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës së Lartë **9%** e totalit, ose 65 nga 709 vendimesh të analizuar¹³. Pjesa tjetër prej 644 vendimesh ose **91%** e totalit dalin jashtë këtij afati (periudha e analizuar Janar-Dhjetor 2015). Kjo do të thotë se, për

¹³ Janë 4 vendime nga 599 në total të analizuar që nuk kanë të dhëna të jaftueshme për t'u amrrë në këtë analizë

vitin 2015, dispozitat e nenit 64, pika 314 e ligjit 49/2012, të ndryshuar kanë gjetur zbatim në masën **9%** në veprimtarinë gjyqësore Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (shih grafiku 6)

Tabela 9, Grafiku 6

NR.	Fasha Kohore	Numri I vendimeve
1	0 - 10 dite	65
2	mbi 10 dite	644
	Totali	709



Kohëzgjatja mesatare e dorëzimit në sekretarinë e GJL të një dosje gjyqësore të vendimuar gjatë 2015-ës rezulton të jetë 41.8 ditë. Kjo shifër e tejkalon 4 herë afatin që parashikon ligji 49/2012, i ndryshuar për dorëzimin e dosjes për çështjeve administrative në shkallën e tretë të gjykimit. Nëse kjo e dhënë do të kontrastohej me parashikimet që përmbante neni 19 i ligjit 8588, datë 15.3.2000, atëherë afati ligjor i përshkruar në ligj do të rezultonte i kaluar me vetëm 11.8 ditë.

Koha më e gjatë e dorëzimit të një dosje në sekretarinë e GJL për çështjet e vendimuara në 2015-ës nga Kolegji Administrativ është 309 ditë. Kjo është çështja me palë paditëse Shoqeria Tregetare "N.P.V Internacional Korca" Sh.P.K dhe palë të Paditur Qendra e Furnizimit Material Teknik (Nr.Akti: 11243-01029-00-2011)

Në tabelën 10 jepet një renditje e 50 çështjeve të vendimuara në vitin 2015 që reflektojnë edhe vonesat më të mëdha në dorëzimin e dosjes gjyqësore

¹⁴ Neni 64, **Shpallja dhe depozitimi i vendimit, pika 3** : Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

Tabela 10

50 rastet me ekstreme te dorezimit te vendimeve, viti 2015				
Nr.	NR VENDIMI	DATE SEANCE	DATE DOREZIMI	DITE GJITHSEJ
1	3854	17.11.2015	23.02.2016	98
2	2070	28.02.2015	08.06.2015	100
3	2069	09.06.2015	18.09.2015	101
4	3403	13.10.2015	24.01.2016	103
5	2192	07.04.2015	20.07.2015	104
6	4189	19.03.2015	02.07.2015	105
7	3093	02.04.2015	16.07.2015	105
8	3495	20.10.2015	03.02.2016	106
9	3673	03.11.2015	17.02.2016	106
10	2750	28.02.2015	15.06.2015	107
11	3175	29.09.2015	14.01.2016	107
12	3678	03.11.2015	18.02.2016	107
13	3533	02.04.2015	20.07.2015	109
14	3733	02.04.2015	20.07.2015	109
15	3903	10.11.2015	03.03.2016	114
16	3906	10.11.2015	03.03.2016	114
17	4614	06.10.2015	29.01.2016	115
18	4639	28.05.2015	21.09.2015	116
19	4637	06.11.2015	03.03.2016	118
20	4647	20.10.2015	17.02.2016	120
21	4186	19.05.2015	18.09.2015	122
22	4645	09.12.2015	11.04.2016	124
23	2612	13.01.2015	25.05.2015	132
24	3094	20.01.2015	03.06.2015	134
25	3397	20.01.2015	03.06.2015	134
26	2598	20.01.2015	03.06.2015	134
27	9379	12.03.2015	28.07.2015	135
28	3499	20.10.2015	03.03.2016	135
29	3364	13.01.2015	03.06.2015	141
30	4643	24.11.2015	13.04.2015	141
31	1322	28.02.2015	22.07.2015	144
32	3360	28.02.2015	23.07.2015	145
33	3238	28.02.2015	29.07.2015	151
34	2228	05.02.2015	07.07.2015	152
35	1317	19.04.2015	18.09.2015	152

36	2603	15.09.2015	17.02.2016	155
37	2962	15.09.2015	17.02.2016	155
38	2832	12.02.2015	20.07.2015	158
39	3586	10.02.2015	20.07.2015	160
40	3672	03.11.2015	14.04.2016	163
41	3779	05.11.2015	16.04.2015	163
42	3985	05.05.2015	26.10.2015	174
43	2590	22.01.2015	20.07.2015	179
44	3399	13.10.2015	11.04.2016	181
45	3174	29.09.2015	04.04.2016	188
46	3319	06.10.2015	11.04.2016	188
47	3882	10.03.2015	18.09.2015	192
48	4439	26.11.2015	11.06.2015	198
49	2961	15.09.2015	11.04.2016	209
50	2960	15.09.2015	20.07.2016	309

Nga një përlllogaritje e posaçme, realizuar nga INFOÇIP, rezulton se në total, për dosjet e vendimuara në 2015-ën nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, u akumulua një total vonesash në dorëzim prej 22549 ditësh, ose rreth 61 vjet në total. Duhet theksuar se kontrastimi në këtë rast është bërë me afatin ligjor që parashikohet në nenin 64, pika 3 e ligjit 49/2012, *të ndryshuar*.

IV. Legjitimiteti dhe Baza Ligjore

Ligji Nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin E Mosmarrëveshjeve Administrative (ndryshuar me ligjin nr. 100/2014)

KREU VIII REKURSI NË GJYKATËN E LARTË

Neni 60

Dërgimi i rekursit në Gjykatën e Lartë

1. Gjykata administrative e shkallës së parë dërgon rekursin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e rekursit, aktet e komunikimit të rekursit, kundërrekursin, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën e Lartë, brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve.
2. Gjykata e Lartë shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi.

Neni 61

Gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë

(ndryshuar me ligjin nr. 100/2014)

1. Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.
2. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton, me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara.
3. Gjyqtari relator përgatit relacionin, duke pasqyruar në të, veç të tjerave, edhe përmbajtjen e vendimit të ankimuar, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, prapësimet e paraqitura në kundërrekurs, shqyrtimin e fakteve që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe propozimin e tij për zgjidhjen ligjore të çështjes.
4. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.

Neni 62

Gjykimi në seancë gjyqësore

1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se:
 - a) rekursi është paraqitur ndaj një vendimi të apelit administrativ, lidhur me gjykimin e aktit nënligjor normativ;
 - b) konstaton se vendimi i apelit administrativ është i ndryshëm nga praktika e kolegjit administrativ ose edhe e kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë;
 - c) vlerësohet e nevojshme nga kolegji administrativ thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes.
2. Vendimi i mësipërm, data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore, të paktën 15 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore

Neni 64

Shpallja dhe depozitimi i vendimit

1. Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar.
2. Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 10 ditë.
3. Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

Programi i monitorimit të Gjykatave

